




Yllka R. Imeri

Ka lindur më 30 shtator 1992 në Vranjë.

Shkollën fillore dhe të mesme e kreu në Bujanoc "Kosovë Lindore".

Diplomohet në Universitetin e Prishtinës dega Gjuhë shqipe (2011/12-2015)

Punon si redaktore dhe profesoreshë.

Fituese e shumë çmimeve në gara të recitimeve.

Aktiviste si Mediatore gjatë viteve 2009/10

Fituese e çmimit "Boksierja më luftarake" në turneun "Tërnoci 2009"

Libri "Enigmë" është libri i parë i botuar me poezi.

Yllka R. Imeri

ENIGMË

- poezi -

Yllka R.Imeri

ENIGMË

- poezi -



Botimi i këtij libri u mundësua nga “BRITISH SCHOOL”,
Fushë Kosovë dhe Prishtinë

Recensentë:
Behar Gjoka
Sali Bashota

Redaktor:
Flamur Maloku

Arti grafik:
Eva Kukaleshi

© Autori, 2015

Shtëpia botuese Albas
Në Tiranë: Rr. “Budi”, pallati “Classic Construction”, nr.2
Tel: 00355 42 379 184; e-mail: info@albas.al
Në Tetovë: Rr. “Ilinden”, nr. 105
Tel: 00389 44 344 047; e-mail: albas_te@yahoo.com
Në Prishtinë: Rr. “Muharrem Fejza”, p.n.
Tel: 00377 45 999 770
e-mail: albas_pr@yahoo.com

Shtypur në shtypshkronjën:



“Enigmë” titullohet përmbledhja e parë e Yllka R. Ymerit, një tekst poetik, që mëton shpërfaqjen unit të poetes, me të gjithë dritëhijet dhe fibraturat e veta. Librit strukturohet në dy cikle, Dashuri dhe Jetë, që mundëson zbulesën e dy vatrave kryesore të frymimit kreativ, të një dëshmimi universal, të cilat janë qendër e shkrimit poetik në secilën fillesë të autorëve, të letrave shqipe dhe më gjerë. Si ndjesi më thelbësore, varësisht hapësirës së teksteve, është marrëdhënia me fjalën, e cila përgjithësisht vjen e shlrishme, me vargun, që shqipton pentagramin e vargëzimit të lirë, duke endur një poetikë të subjektives dhe konkretes, pa shenjzime zbukurimore. Poezia e Yllka Ymerit, në zgjedhjet tematike, në aparatin estetik, nuk rend pas figurës apo metaforës, jo se ato mungojnë plotësisht, por më tepër vrapon pas poezisë që thotë atë që ndjen, me mënyrën vetjake, duke ofruar një shans për të ndërë pulsën e poezisë së një breznie tjetër, që jeton realisht dhe artistikisht në mijëvjeçarën e ri. Më tepër se sa komenti mbi të, libri i parë i autores, Enigmë, është një realitet që shijohet në lexim, është një shans për të uruar autoren: Udhë të mbarë në shtegtimin e letrave, ku fillimi është caku që të hedh në garën e ligjërimi si vlerë estetike, ku pak mbërrinë...

Behar Gjoka

Poezia e Yllka Imerit është enigma e parë e ligjërimin të saj poetik për të hyrë në botën e letrave. Kjo hyrje në labirintet e krijimit i ka përballjet e veta, megjithatë Yllka Imeri arrin t’i sistemojë me gjeturi ato gjëra të shprishura të realitetit, të cilat e preokupojnë apo e pushtojnë jetën e përditshme, për t’i fuqizuar në udhëtimin e saj përmes shprehjes së bukur poetike. Shpërthimet krijuese të Yllka Imerit sikur lëvizin përbrenda një paradoksi ekzistencial, i cili irealitetin, jo rrallë, e rikthen në figurë të përfytyruar, madje e shpërfaq me plot kujtime, ëndrra, aventura, dhembje, por edhe revoltë, heshtje, mallkim, duke e kërkuar zotërimin e ndjenjave dhe mendimeve. Yllka Imeri me këtë libër dëshmon përkushtim, talent dhe aftësi krijuese, prandaj poezia e saj është një trokitje e lehtë lirike, e cila e ka pasionin dhe ndjeshmërinë e vet...

Sali Bashota

DASHURI

Mi ktheu plumbat mbrapsht dhe shkoi
Iku si një lypsar larg meje
Si Monaliza, në pikturën e Davinçit,
Më duket se më shikon kah të shkojë
E unë zemër peng e thyer
Mbes si skulpturë e shtangur!

KLITHMË

Ngërthej në vete
Ato gjërat e shprishura
Që më pushtuan jetën
E mi morën ditët e mira
Më lanë të vobekët
E çdo hap që bëra
Përjetova mjerimin...
Pranë varrit më të bukur
Kërkova shpëtimin
Edhe qyqet në rrem
Më dhanë mallkimin
E unë klithë në heshtje
Për ta larguar trishtimin!

SINFONIA IME

Duhesh ta lexosh dhe ta kuptosh mes rreshtave
Se cfarë desha të të them
Natyrisht se nuk jam mendje e zakonshme
Por jam gjeni
Unë e di kur e përshkruaj atë korbin e zi
E si mund ta kuptosh ti...
Se di!
Unë ngritem në qiell në mesnatë
Lozë me yjet
E në mëngjes vi tek ti...
Si sirenë i bie detit mu në mes
Dhe vie në tokë si njeri

Unë di të bëj zgjedhjen dhe zgjidhjen
Kur gjërat i kam aty
Unë nuk flas, buzëqesh
Dhe shkruaj për të ardhur fjalët deri tek ti
Edhe lumturia do e humbash kuptimin
Kur ne dy do jemi një
Unë numëroj ditët e netët
Për tu bërë 365 saktësi
Në skutë e ngujuar
Bëj vetëm vepra për të treguar histori
Çdo gjarpër që thithi gjakun
Në fund u kuptua kush ishte ai..
Sinfoni ime
Melodi e kompozuar aty për aty
Nuk trembem, e as frika nuk ma kaplon palcin
Kur të thurr ty
Askush askujt nuk ja kuplon lotin
Kur të lexon të heshtur ty.

AVENTURË

Me ty shijova
Ato skenat erotike
Që pushtonin botën
Dhe ne të dy..
Me ty çdo rol luajta
Se ishte skenari i përgatitur
E aktor i lindur ishte ti..
Me ty ndjeja çdo gjë
Dhe çdo gjë më eksitonte veç kur e mendoja
Edhe OH' në e Anton Pashkut
Ne e tejkalojmë
Me veprimet tona..
Aktorë pornografik
Të mbyllur në një skenë pashikues
Ne luajm rolin ashtu siç dëshirojm
Edhe po të jemi verbues.

VRASËS I HESHTUR

Të mbaj pezull
Të përqafoj
Të puthë
Të kafshoj
Dhe ti vret...
Vrasës se pranon
Ke frikë se të kaploj
Unë gabo, që të ekzitoj...
Por e bëj
Ti vrasës i heshtur
Të zura
Në trupin tim
Të etur, të brisht
Për pak dashuri
Në eposin tim.

PENG I DASHURIË SIME

Nuk do të lë të shkosh
Ti nuk e kupton se sa shumë të ndiej
Ti vetëm e sheh
Në bebëzat e mia të syve
Dhe prapë s'mund ta shpjegosh
Ku do të shkosh?
Nuk të lë dot të ikësh
Larg meje
Dua të jemi të lumtur
Pa menduar se nesër çfarë do bëhet
Ne vazhdojmë të shijojmë
E nuk cënojmë lirinë tonë
Do të mbaj brenda zemrës sime
E nuk do të lë të shkosh
U përpoqa të jem çfarë ti ke nevojë
Andaj të mbaj peng të dashurisë sime
Në kujtimet e mia.

ME TË PA SI SUVENIR

Ofshama jote ma ngrit
Epshin për dashuri
Era jote e ëmbel më godet në tirani
Uragan i madh mbi mu e ty
Prapë si vijë lakore mbesim ne të dy
Me të pa si suvenir
Kisha mall për ty
A thu nga t'ia filloj të puthë e të ledhatoj..
Me egërsi hamshore
Ty të shijoj
Suvenir mbi ty, jam e do qëndroj
Në ëndërrat paqësore
Të prek e të kafshoj
Suvenir do mbetem
Që pranë teje të jetoj!

MBRETËR PAKURORË

Sa e hapur për të arritur
Aty ku duhej
Sa e mbyllur brenda vetës
Në kujtime të shumta
Çfarë imagjinate pafund
Më godet e më thotë bëje, realizoje,
Sa mbretër hyrën,
E dolën, por pakurorë..
Dhe prapë ngela vetëm
Por..
Princesha e dikujt në ëndërr
Që venitem e shkrihem
Tek ata
Si flutur para tyre
Nuk njihem...

NË ANKAND

E jotja do jetë bota
Kur mua do më kesh..
I yti do jetë qielli
Kur do më prekësh...
Do ndjehesh i fortë kur dorën ta jap
Do lundrosh...
Kur më shikon në sytë e mi të zi vezullues
Aroma ime do të bëj kërkues në ndërtimin tim
Joshëse pamja ime, do të pushtoj
Në Ankand do të qëndroj
Po më deshe eja më merr
Aty më ke...

Ne
Ne flem së bashku pa bë asgjë
Në kështjellën ton të ndërtuar prej vitesh
Ne shijojm parrëzuar gjë
Dhe prapë e njehta gjë përsëritet...
Ne ndahemi për t'u bashkuar prapë
Si hëna e plotë kur venitet
Ne shndrisim edhe në errësirë
Edhe kur yjet boshatisen...
Ne vuajm pagjumë, pangrën, papij
Të etur për dashuri
Ne kalojm shumë kufi
Dhe prapë mbetemi
“Ne të dy”

PURO

E tronditur nga ngjarjet e jetës
Kërkonte lëmosh nga çdo nektar
E etur për të shijuar dashurinë e parë
I binte vërdallë çdo gjë që kishte përballë
Puro
Në shikimin e saj me sytë në ballë
E pangopur
Filtronte tri herë në dite
Duke kafshuar
E duke ofshuar
Në lëngun e ti të bardhë
Kënaqësi qiellore
E quante oralin e parë
Skenat 69 i kishte kujtime të pandara
Në sirtarin dëshmitar
Qante e qeshte
Duke pranuar mysafirë prej mishi
Në vrimën e saj të hapur për djajë..

E ZHVESHUR PARA TEJE

Në labirint më çonte etja për ty
Parashikoja cdo gjë edhe pa të pasur afër
Doja të ndjeja një ah nga ti
A mrekullia e botës, ah!

Unë e zhveshur para teje
Si lavire pa turp
Nën kthetrat e tua
Ndjehem e pushtuar

Çastet erotike i shiojmë si të marrë
Të uritur si ujqit për mishin e qengjit në skarë
Të pangopur si egërsira
Kafshonim mishin e gjallë

Në mes të epshit humbëm të dy
Ndezëm shtratin e artë
Dhe krijuam në vete
Enigmën e flaktë

MË QUAJTI EGËRSIRA IME

E unë si Divë e mllëfosur përballë tij
Ku shpirti i trazuar shpërthente dashuri
Në gënjeshtër e intriga përballë realitetit
Çdo gjë ishte eufoni...
Si kukull e dehur në gënjeshtër e tij
Pa turp valltare e një klubi nate
Ku të nesermen ikte në çmenduri
S'ishte më heroina e dikujt
Tash gëzonte epitetin e tjetër kujt
Zemër e thyer pa llogon e askujt!

JETË

“Po pati jeta mënyrë, ajo gëllitë pa e shikuar”

ZGAFELLAT E JETËS

Sapo hapa kokërdhokët e syve
M'u duk jeta në një Botë të re..
Në një Botë ku jeta ishte e stërm bushur
Me rrjetën e marimangës...
Ç'zgafellë...
Kur vetëm qaja
E askush nuk më kuptonte se çfarë kam
Më fusnin vetëm në gjirin e nënës
Pa qenë e uritur fare
Plaste zemra dhe ndryshonte të rrahurat e saj,
Sa jetë mizore na qenka këtu,
Ku askush nuk më uroj mirëseardhje,
Apo ndoshta unë nuk i kuptoja,
Se kisha gjuhën time me tinguj apofonik.
Ç'zgafellë e errët.
Shoh vetëm mjerim,
Edhe kur muzgu bie pas perëndimit
Çdo gjë mbetet trishtim.

AORTA E ZEMRËS TIME

Jeta nuk më dha mjaftueshëm për të qenë e lumtur,
Do të kisha dashur edhe pak ditëjete,
Për ta kuptuar se kush ishte skenaristi i jetës time,
I cili më futi në një dramë...
Ku personazhet aktrojnë përtej imagjinatës së tyre.
Aty ku gjërat e liga nuk kanë të ndalur fare,
Ku ditët e ngrohta bëhen të ftohta...
Si acari ne Polin e Veriut,
Aty ku ai që thithë gjirin,
E kafshon tjetrin pa u turpëruar fare...
Oh sa jetë mizore..
Ku e drejta vlerësohet si e padrejtë,
Ku tingulli i një gajdeje
Dëgjohet aq sa tingulli i një gitare...
Aty dhe Aorta e zemrës time rrah pa pushuar fare...

DEZHAVY

I pranoj të gjitha mëkatet e mia,
 kodo qoftë, në autobiografinë time, ose në poezitë e mia,
 ashtu siç bënë shkrimtarët e huaj,
 e unë jo pse dua ti ngjaj atyre,
 po se dua të tregoj realitetin,
 ku çdo ditë e jetës time është “Dezhavy”.
 Si mumje në monedhë e ngurosur,
 dua të ikë, të fluturoj ka qielli blu,
 por litarët nuk më lënë,
 janë shumë të fortë, nuk mund ti grisë..
 ndoshta nesër lindë dielli,
 dhe lindë një shpresë për të jetuar,
 ndoshta më nuk do të zhytem në mëkatet e njëjta,
 ndoshta nesër atë jetën “Dezhavy” do ta ndrydhë..
 por çfardo gjëje që do të bëjë prap nuk mundem ta menjanoj të kaluarën,
 a thua kaq e dobët jam unë..
 Ku ta marrë guximin dhe ti mbledhë forcat për ta goditur Murin Kinez,
 të ndërtuar në jetën time...

TROKAS

I trokas ditëve të jetës
 Për të ma hapur porten
 Çdo mëngjes...
 Mysafire nderi
 Në odën e një globi të rrumbullakët
 Çdokush që vinte
 Vinte duke qarë, pa e kuptuar pse qante...
 Shkonte duke qeshur, pa e ditur pse qeshte...
 Trokas...
 Edhe në derën e murgut
 Për t’ju rrëfyer atij për të bëmat e mia
 Më shikonte i habitur, e papritur më tha:
 “ZEMËR E HUAJ”
 Mëkat
 Mëkat
 U shporra nga aty
 Ika me vrap në një ishull të huaj
 Aty ku gjërat ndodhnin pa i pritur fare
 Aty valët e detit trokisnin
 Dhe bënin zhurmë të madhe
 Aty akrepat e orës nuk lëviznin fare...

BOSH

Dhe bulevardi i boshatisur
Edhe zemra bosh
Më s'ka buqeta me lule plot
Bonjake në bollëk
E boshatisur!
Pa baft...
E eliminuar,
Evitoj boshatisjen për jetë e mot
Por prapë mbetem bosh
Edhe kur hëna fshehet mbas reve
Unë fanitem si hije pas saj
Dhe prapë çdo gjë ngelet BOSH!

ERZ

Ç'erz i zi
Kur zëri yt më vije si tingull akustik
Sa diabolik
Ekspleatove çdo gjë
Derisa të evitova
Ti farmakose ditët e jetës sime
ERZ i zi!
Ekzekuton eufoni
Eksplaton deri atje ku destinon
E unë deskriptoj me debolesë
E vobekët nga jeta
Për ditët e erzit të zi!

AKTI I MËKATIT TIM

Si ngjan fleta e parë të fundit jo..
Filloj me një buzëqeshje, mbaroj me një humbje!
Ishte mëkat..
Kur si qyqe në bli të thatë vajtoja, gjëmoja, gjakoja..
Hapet akti i mëkatit tim,
Ta shohësh është trishtim,
Ta lexosh ndjenë mallëngjim,
Sepse aty vdes dhe prap ringjallem,
Mishërohem dhe bëjë mëkate si e paturp,
Vajtoj, pendohem dhe përsëri vazhdoj të meditoj,
Fluturoj për në qiell blu dhe prapë kthehem në Tokë,
Nuk ngaj më me as një njeri,
Por me Alienët pa flok,
Tani mos ke frikë..
Se kam marr forcën falje me të kërku,
Është mëkati im, në këtë mister që më ka dërgu
Mbyllet Akti me lot duke kujtu!

N' TERR

Edhe sonte n' terr
E unë t'u jetu në ketë Kosov, t'vogël e t' varfun
E t'uj bo drit vetit veç me ni qiri
Ku flaka e tij pom kall për s'gjalli
Pom ban mi kujtu
Tragjeditë që m'kanë pushtu jetën teme...

E kjo flakë e këtij qiri
Pom ban me i bo vetit pyetje
Pse?? Ndodhën ton këto gjana bash n' mu..

N' terr po digjem t'uj menu
Se nesër prapë ka me lind dielli
Prapë jeta ka me vazhdu!

ERRËSIRË NË QIELL

E unë venitem pas hënës
E cila fshihet pas reve të zeza
Dëgjoj vetëm ulërimat e qenve endacak
Që kërkojnë ndihm
Eh bota rrotullohet
Dhe unë rrotullohem bashkë me të
Unë venitem pas hënës
E ajo fshehet pas reve të zeza!
Dëgjoj pëshpërimën e lisave të mëdhenj
Që tundin fletët
E mua më kaplojnë të dridhurat
Nga era e freskët
Natë vere por e errët!
Nuk është as një Yll në qiell
Që ta shikoj e të flas me të
Del vetëm hëna nganjëherë
Dhe ikë...
Sikurse frikësohet prej meje
E unë venitem
Duke kërkuar daljen e saj
Prej reve të zeza.

ME MAHRAME

Më vran terri i psikikës
E shoqnia e kohës
Tuj kujtu burrat e dheut
Të Sharrit, e të Rugovës
Me mahrame në kokë
Derdhun gjakë për tokë
Zgjohu RUGOVAS
Thuaja kangës me sharki
Tregoj botës mabanë
Se edhe këtu është SHIPNI
Moj grykë arbnore
Tokë dardane
Trima kosove
O ju bjeshkë shënjëtore
O plisa atëror
O plumb i pa epur
Në shpirtin burrënor
Me fjalë, e besë
Në zemër Rugovë.

NDRAGUR

Nëpër rrugët ku ke ecur
 Do të shkel aty prapë
 Do të ecë ngadalë
 Vë bast se je larg
 S'kam më fytyrën tënde
 As zërin që më pëlqen
 Me ndrag...
 Dikush pret diku
 E ngulitur si dru
 Ç' dhimbje pashërim
 Ç' kujtim pambarim
 Ç' ndarje papërfundim

MË BANI ME QA

Ajo histori trishtuse
 Më bani mu ni shumë keq në jeten teme
 E me qa pa rreshtun fare...
 Në odë të banes e ulun kur ai lajmi i zi më tronditi
 Sa keq u nieva
 Se i ton qielli më ra mi kry
 E më thej zemren në dysh...
 Nuk e kajsha vetën,
 Po i kajsha babë e nanë që mbetën vetum
 Edhe ai magari i babës iku...
 Si me pas ftyren e zezë
 I dashmi i nanes shkoj e su kthy mo
 Gjigandi i motrës më la vetum
 Jo pse s'pat me ngran e me pi
 Po ndoshta jeta në kohën e tyne paska me kanë kush e di se çka.
 Më dha barrën ton mi shpind
 A thu muj mi dal hak kësaj jete
 Tui menu se nesor bahet mirë...

UNË

Stuhi...

Në mitin e malit gjendem

Si zanë përralle të vi

Mos u tremb

Nuk të bëj gjë

Vetëm dua të të mbroj...

Duhet!

Duhet me u pajtu

Me jetën e rreme

Duhet me ditë

Me aktru!

Duhet me u bâ para tyne: “engjuj”

Duhet me e bô me men

Se kjo tokë nuk oshte e jôna

Duhet me ditë me jetu në andrra të mira

E duhet me ditë kon me dâsht e me marr me vete

Me ni planet tjeter

Me shku shumë largë prej këtu

Diku ku jemi vec unë e ti

Diku ku jeta kish me u kân ma ndryshe

Na duhet me provu!

Çdo sen!

Por na prapë duhet me u pajtu

E duhet patjetër

Me kujtu njâni tjetrin!

Na duhet me e pa botën

Nga ai këndvështim i yni

Na duhet me ditë me ba implikatur

Duhet me e pa krejt globin

Sikur me kân i rrafsh

Pa koherencë, pa kohezion

Por na duhet me pas argument bindës

Për me kân ashtu qish duhet!

KOHA U NDAL..

Nuk arrita të të thosha asgjë
Ti ike u trete diku shumë larg meje
Nuk je më aty ku ishe dikur
Jam e vetme e humbur në mendime
Më rrjedhin lotët nga sytë
Sepse kanë shumë kujtime
Çfarë të bëjë të vazhdoj jetën
Apo të jetoj me fantazinë time
Në çdo cep po i mbledh forcat
Por është e kot,
Çdo ditë po e kaloj e heshtur
Është vetëm kjo fleta e bardhë
Që ma di hallin mua,
Është vetëm kjo tek e cila shprehem

Herë herë e ndrydh, e hedh në plehëra
Le të ikë edhe kjo le ta hajë derqi
Me gjithë këto vargjet e mia
Dua që të jem krejtësisht e vetme
Dhe ta ndaloj kohën aty
Ku nuk ka as brenga, as mllef
As mall, as kujtime
E asgjë të vetme,
Dua vetëm që të jem me veten time
Ballë për ballë si asnjëherë tjetërë
E të krijojmë dialog
Tani kam ndaluar kohën
Jam vetëm me veten time!

SHKO!

Më mirë ikë
 Qëndro larg meje
 Se po erdhe tek unë
 Do të shpojë mu në zemër
 Me takat e Anna Kareninës
 Më mirë ikë
 Mos u mundo t' ma shtrëngosh dorën
 Sepse do të shtrëngosh shumë gjemba
 Më mirë shko...
 Tretu diku
 Mos kujto as fytyrën time
 Sepse të vij pas si hije e trishtër
 Largohu nga unë
 Qëndro në horizont..
 Kush e di ndoshta edhe atje do vij
 Me një frymë tunduese
 Ndoshta edhe atje të shoh të vetmuar

Por më mirë qëndro largë meje
 Se të jesh afër do të shkelë me çizme torturuese.
 Ti e di, më mirë se cdo kush se kush jam unë!
 Ne mund të jemi dy
 Por asnjëherë s' do jemi një!
 Më mirë ikë në rrugë pakthim
 Se sa të godas me plumb mu në ball
 Më mirë qëndro i vetmuar
 Se sa të kesh pranë vetes helmin e gjarpërit
 Më mirë shko në qiell
 Se sa të qëndrosh pranë Kleopatrës së helmuar
 Më mirë shiko nga lartë se çfarë bëhet poshtë
 Se po të jesh poshtë nuk do shohësh asnjë gjë
 Më mirë mendo për vete
 Se të mendosh për mua nuk ke fituar asgjë!

PARIM

Isha një ndër kujtimet më të bukura
 Aty ku ishin kujtimet e jetës së tij
 Isha perlë që shndritja
 Në sy përballë tij
 E egër
 Hamshore në një pjesë të jetës së tij
 Ndarje
 Bashkim
 Por kurrë thyerje e një parimi të tij
 Sa jetë ligjore kishte ai
 Edhe dashuria për të kishte një kufi
 Akcept i paakceptueshëm
 Në ngjarjet e jetës së tij
 Nën tymin e duhanit shfaqte ironi
 Idealin për parim e mbronte gjithnjë
 Sa urdhër pabazë
 Për një “DASHURI”

TELESPEKTATORE

Më nxiti muza aty afër teje
 Dhe unë krijoja një Botë përplot magji
 E shtangur,
 E mekur,
 Para teje!
 Ti vije si një stuhi në kohët pa shi.
 Më godet, më plgos,
 Më vret dhe prapë më ngjall,
 Në krahët e tu shpirti më rrëshqet,
 Ti lozë me të sikur valltar
 E unë telespektatore e natës së parë!

UNË E TI

Gjithmonë të kam zgjedhur ty...
Edhe kur gjërat ishin shumë të vështira
Shumë largë ishim...
E rrugë të gjata na ndanin,
Lumenje të shumtë na tretin,
Në kristalet e dallgëve,
Por ne prapë jemi aty ku ishim.
Frymojmë lirshëm...
Sepse ne e duam lirinë...
Ne kemi ëndrra të cilat mundohemi t'i realizojmë...
Ne fluturojmë..
Edhe pse shumë large ne arrijmë të jetojmë...

MBETËN VETËM KUJTIMET

Çdo gjë u shua apo jo...
Gjithçka treti e më nuk është kthyer
Mbetën vetëm kujtimet si dëshmi e së kaluarës
U shuan edhe Yjet nuk ndriçojnë më
Mbeti vetëm Hëna e cila më ndriçon rrugën ngado që ecë
Por edhe ajo ik nga një herë
Prapë mbetem e vetmuar
E zhytëm në kujtime
A thua çdo herë kështu do të jetë?
Sikur ta dija edhe sa faqe do të mbarojë ky kapitull
E të përgaditem për një kaptinë të re
Do ti zgjedh Aktorët
Dhe një skenë të re
Të mos vdesim nga e vërteta po të jetojmë me të
E jo për çdo fjalë që lind ne të vdesim
Apo të mbesim pengë të saj
E më mirë e kaluara le të mbetet
Kujtim për vargjet tona.

CA PIKA SHIU

Ca pika shiu dëgjoj që bëjnë zhurmë
 mbi pullazin e shtëpisë sime,
 Më fusin në mendime,
 Në një botë me kujtime intime.
 E sikur të jem mbi pullaz,
 Ndoshta do të mund ta prekja qiellin e errët që lëshon shi,
 Po ky shi është freski,
 Që më qetëson shpirtin tim,
 Sikurse të bëja joga.
 A thua do të mund të vazhdojë kështu,
 Duke qëndruar e heshtur,
 Në mendime e në kujtime të thella,
 Ashtu e lagur nga shiu mbi pullaz,
 E unë vazhdoj citimet e mia,
 Ti hedh në këtë letër të bardhë,
 Ku ngjyra është bërë njollë e zezë,
 Sikurse qielli i errët.
 A do të mund ti lexojë më pas këto fjalë,
 Apo vetëm do ti mbajë në memorien time,
 Dhe s' do të mund më të shqiptojë as edhe një fonemë,
 Nga njollat e zeza, ku asgjë nuk shihet qartë.
 Vetëm se dëgjohet shiu mbi pullazin e shtëpis sime,
 E citimet e mia mbeten pa frazë.

“FUND PA FILLIM”

Sa do të doja të prehem në paqe,
 Aty ku lulet mbi varr do të më vijnë,
 Sa do të doja të jem e zhdukur,
 Nga kjo botë, ku se ke as lirinë,
 Si zog shtegtar po udhëtoj,
 Kinse për pak dashuri,
 Aty ku morra qumështin dikur,
 Më se ndjej të njëjten dashuri,
 Vetëm sa vij e pikëllohem më shumë,
 Vetëm sa netët më ikin pa gjumë,
 Dhe prap aty ku nuk duhet të jem,
 Jam prap aty unë...
 Ky është një fund pa fillim,
 Ku nuk kam më as një fjalë,
 Vetëm hesht si e vdekur,
 Për të mbetur si e gjallë.

Melodi e zemrës
 Shumë kolona zanore
 Si enigma të dhimbjes
 Të papara ndonjëherë
 E të padëguara...!
 Të imagjinuara, brenda në thellësin e shpirtit...
 Të përplatura për mure
 Që qëndrojnë të shtangura, nga errësira!
 Nuk ndritë më asgjë, sepse cdo gjë u shua atëherë kur duhej ndritur
 Kthehet prapë dhe bëhet rutinë ajo melodi e zemrës sime
 Ikë të lutem ikë shporru nga këtu
 Gjejë universin pakthim, atje ku nuk destinon kurr...
 O melodi e zemrës të lutem më fal,
 Sepse drama mbaroj,
 Vizitorët ikën,
 Dhe unë ngelem “AKTORE E PËRKRYER”

ENIGMË

Heterogjene çdo gjë
 Nuk pashë asgjë
 Ishte terr
 Dhe mura të larta kishte
 I vrenja me duar...!
 Me steriotipe e mbuluar
 Nga vernakulartë e kabluar
 Pozitë e paharruar
 Kënd i trishtuar
 Tërësi e paimagjinuar
 Kolukim i pa argumentuar
 Dhe vargjet mbetën
 “Enigmë” e pazbuluar.

**INSTITUT ZA NAUČNA ISTRAŽIVANJA I RAZVOJ
INSTITUTI PËR KËRKIME SHKENCORE DHE ZHVILLIM
INSTITUTE FOR SCIENTIFIC RESEARCH AND DEVELOPMENT**

REDAKSIA

Prof.Ass. Dr. Shefket Jakupi, (kryeredaktor)
Yllka R.Imeri (sekretare shkencore)
Prof.Ass. Dr. Azeta Tartaraj
Dr. Roven Vata
Dr. Ylviqe Kraja

DREJTOR I REVISTËS

Prof.Ass.dr. Elez Osmani

CIP – Каталогизација у публикацији
Централна народна библиотека Црне Горе, Цетиње 330(905L)
NAUČNI bilten: ekonomska istraživanja
Buletin Shkencor: hulumtime ekonomike

E- ISSN 2337-0521

ISSN 1800-9794

COBISS.CG-ID 20586256

Shtëpia botuese Qendra për hulumtime ekonomike -Ulqin

Prof.Ass. Dr. Shefket Jakupi, (kryeredaktor)

Korrektori dhe punoi në kompjuter

Prof.Ass.Dr. Shefket Jakupi

E drejta e autorit :

Instituti per kerkime shkencore dhe zhvillim
"Redaksia e Buletinit Shkencor"
Ulqin

Adresa e redaksisë :

Instituti per kerkime shkencore dhe zhvillim
"Redaksia e Buletinit Shkencor"
Ulqin ++382 69 265 707

web.: www.ekonomskiinstitut.com